

Raporti i pjesëmarrjes – Sesiioni i Energjisë, IC-EEE 2025

Data dhe vendi: 23–25 Tetor 2025, UBT Science and Innovation Park, Prishtinë, Kosovë

Raportuesi: Agron Bislimi

1. Hyrje

Konferenca Ndërkombëtare e UBT-së organizohet në mënyrë të rregullt çdo vit në kampusin e saj në Lipjan. Në kuadër të *International Conference on Energy Efficiency Engineering (IC-EEE 2025)*, u zhvillua sesiioni i Energjisë, i cili ishte pjesë përbërëse e *14th UBT International Conference for Business, Technology and Innovation*.

Tema kryesore e konferencës këtë vit ishte **Energy Transition dhe Digitalization**, duke mbledhur studiues, doktorantë dhe ekspertë të industrisë nga Kosova dhe jashtë.

Qëllimi i pjesëmarrjes ishte të njohim trendet më të fundit në energji të rinovueshme, efikasitet energjetik dhe teknologji dixhitale për sistemet e energjisë, duke krijuar një platformë ndërkombëtare për prezantime, diskutime dhe bashkëpunime shkencore.

Konferenca trajtoi një spektër të gjerë temash në fushën e energjisë dhe teknologjive të saj, duke përfshirë tranzicionin energjetik, sistemet elektrike, rrjetet e zgjuara dhe mikrorrjetet, energjinë e rinovueshme dhe ruajtjen e saj, automjetet elektrike, inteligjencën artificiale, qelizat me karburant hidrogjeni, kapjen e karbonit dhe kogjenerimin.




Figura 1: Pamje e sallës së konferencës

2. Përmbledhje e sesionit

Sesioni i Energjisë u zhvillua në **dy sesione** gjatë mëngjesit dhe mesditës. Prezantimet përfshinë temat kryesore mbi **Energy Transition, Smart Grids, Cogeneration, Digital Technologies, Renewable Energy dhe efikasitetin e sistemeve të energjisë**.

Diskutimet dhe pyetjet nga audienca kontribuan në shkëmbimin e njohurive midis studiuesve dhe ekspertëve. Sesioni ofroi mundësi për diskutime dhe bashkëpunime ndërkombëtare.

3. Detajet e secilit sesion

- **Sesioni i parë (10:30 – 10:45):** Prezantime mbi parashikimin e konsumit të energjisë, cilësinë e ajrit, integrimin e sistemeve inteligjente dhe kogjerimin e energjisë. Diskutime mbi sfidat e humbjeve të energjisë dhe efikasitetin e rrjeteve të transmetimit.
- **Sesioni i dytë (10:45 – 12:20):** Fokus mbi zgjidhjet pa SF₆ për sistemet elektrike, teknologjitë dixhitale për modernizimin e sistemeve me bazë qymyr, rolin e qymyrit në tranzicionin e gjelbër, përdorimin e mbetjeve për biomasë dhe biogaz, ndikimin e rrjeteve inteligjente në shpërndarjen e energjisë dhe përdorimin e energjisë diellore.

Coffee Break dhe Lunch Break u organizuan për ndërveprim dhe diskutime informale midis pjesëmarrësve.








Figura 2, 3, 4 dhe 5: Prezantim i një punimi shkencor gjatë sesionit të Energjisë

Gjatë sesionit, aktivitetet u zhvilluan në mënyrë interaktive, duke kombinuar prezantime shkencore, diskutime dhe njohuri praktike, siç ilustron në figurën më poshtë.



Figura 6. Salla e konferencës gjatë prezantimit të një punimi shkencor në sesionin e Energjisë (IC-EEE 2025).

4. Përfitimet dhe përfundimi

Pjesëmarrja në sesionin e Energjisë kontribuoi në njohjen e zhvillimeve më të fundit në teknologjitë energjetike dhe mundësoi shkëmbimin e përvojave me ekspertë të fushës. Sesioni ofroi një platformë të vlefshme për diskutimin e sfidave dhe mundësive në fushën e energjisë, duke nxitur bashkëpunime ndërkombëtare dhe inovacion në sistemet energjetike



Figura 7: Diskutim dhe pyetje gjatë prezantimit të punimit, me profesor dhe pjesëmarrësit që ndjekin dhe diskutojnë çështje të ndryshme

Pas prezantimeve, prezantuesit dhe pjesëmarrësit u certifikuan nga dekani, përkatësisht për punimet e tyre dhe për pjesëmarrje.





Figura 8, 9 dhe 10: Dhënia e certifikatave për prezantuesit dhe pjesëmarrësit nga dekani në përfundim të sesionit